



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KANCELARI

Nr.5240/1 prot.,

Tiranë, më 11.11.2024

**Lënda:** Njoftim për përfundimin e verifikimit paraprak të kandidatëve sipas procedurës “Lëvizje paralele”,

Në mbështetje të nenit 57 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 29 e në vijim, të kreut IV, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe të udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor”, në përfundim të afatit kohor për dorëzimin e dokumentacionit të kandidatëve që konkurrojnë sipas procedurës “Lëvizje paralele” pranë Gjykatës së Lartë, për pozicionin vakant të shpallur me shpalljen e datës 24.10.2024 dhe pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të dorëzuar ju bëjmë me dije se :

- Për 1 (një) vend vakant, pozicioni “*përgjegjës sektori*”, sektori i shërbimeve mbështetëse dhe prokurimeve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve dhe Shërbimeve Mbështetëse , kategoria e ulët drejtuese, III-1, do vijohet me procedurën e “Ngritjes në detyrë”, pasi nuk u paraqit asnjë kandidat sipas procedurës “Lëvizje paralele”.

Duke ju falenderuar,

**KANCELAR NË DETYRË**

**ANILA KULO**